



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 56

Tiranë – E mërkurë, 1 prill 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 19/2020 datë 5.3.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”..... 3313
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 1.4.2020	Për miratimin e propozimit të përbashkët të përgatitur nga Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit dhe Sekretariati i CEFTA-s, për të lehtësuar transportin dhe tregtimin e mallrave të nevojës së parë brenda Ballkanit Perëndimor..... 3317
Vendim i Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile nr. 4, datë 30.3.2020	Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19..... 3325



LIGJ
Nr. 19/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 34/2019, “PËR
ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË
SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA”

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V ENDOSI:

Në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është miradministrimi dhe përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë ose pasurive të sekuestruara nga organet administrative, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.”

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara” (në vijim Agjencia) është institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të sekuestruara me vendim të dhënë nga organet e sistemit të drejtësisë apo organet administrative, administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të konfiskuara, si dhe ruajtjen e provave materiale apo administrimin e tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.”

2. Në shkronjën “b” fjalët “apo nga administratori i pasurisë” hiqen.

3. Shkronja “c” shfuqizohet.

4. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) “Administrator i pasurisë” është punonjësi buxhetor dhe/ose i kontraktuar nga Agjencia, i specializuar në fushën e administrimit të pasurive, i cili është i autorizuar dhe/ose kontraktuar nga Agjencia për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara dhe që koordinon, udhëzon, mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e procedurave ligjore për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, sipas fushës përkatëse që ai mbulon.”

5. Në shkronjën “dh” fjalët “dhe administratori i pasurisë” hiqen dhe në fund të fjalisë shtohen fjalët “apo regjistrimit të pronës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, për këtë qëllim.”

6. Shkronjat “f” dhe “j” ndryshohen si më poshtë:

“f) “Personel i jashtëm”, sipas këtij ligji, është eksperti i jashtëm, i cili administron ose ndihmon administratorin e pasurisë së bllokuar e të sekuestruar me urdhër administrativ, i caktuar nga Agjencia, si dhe punonjësit e tjerë ndihmës të ekspertit.

j) “Urdhër administrativ” është urdhri i lëshuar nga çdo autoritet administrativ me kompetencë ligjore vendimmarrëse për sekuestrim, apo administrim pasurish, sipas legjislacionit në fuqi.”

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat, procedurat dhe strukturën administrative për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë, administrimin e pasurive të sekuestruara nga organet administrative dhe ruajtjen e provave materiale, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.”

Neni 4

Në nenin 4, pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:



“ç) pasuritë për të cilat është vendosur masa e sekuestros ose e konfiskimit, sipas aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”;

d) provat materiale, sipas kuptimit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, me përjashtim të atyre të cilat ruhen në sekretari.”

Neni 5

Në nenin 6, në pikat 1, 2 dhe 4, fjalët “ministri përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 6

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, fjalët “ministrisë përgjegjëse për financat” zëvendësohen me fjalët “ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike”.

2. Në pikën 5, fjalët “me urdhër të ministrit përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar”.

Neni 7

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “b.1”, “b.2”, e “b.3” dhe pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “c.1” e “c.2” me këtë përmbajtje:

“b.1) merr në dorëzim dhe ruan provat materiale, sipas përcaktimeve të nenit 4 të këtij ligji;

b.2) paraqet kërkesë pranë prokurorit për të urdhëruar përdorimin, tjetërsimin ose asgjësimin e provave materiale, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale;

b.3) administron provat materiale, për të cilat organi procedues ka urdhëruar përdorimin ose tjetërsimin e tyre;

c.1) disponon për dhënien e pasurisë së sekuestruar në përdorim të institucioneve dhe enteve shtetërore, në nivel qendror e vendor, si dhe tek të tretët, sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të

rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”;

c.2) çdo kompetencë tjetër apo detyrë e parashikuar në aktin normativ nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike” apo ligjeve të tjera në fuqi.”

2. Në shkronjën “c”, fjala “gjykatës” zëvendësohet me emërtesën “Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar”.

3. Në shkronjën “ç”, pas fjalës “shtetit” shtohen fjalët “në përgjegjësi dhe administrim të Agjencisë”.

4. Në shkronjën “e”, fjalët “ministrit përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

5. Shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) bën verifikimin dhe përgatit dokumentacionin për vendimmarrjet e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, si dhe ndjek zbatimin e tyre.”.

Neni 8

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “ministrit përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

2. Në pikën 2, shkronjat “ç” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:

“ç) harton listën e administratorëve të pasurisë së sekuestruar, të punësuar pranë Agjencisë, të cilën ia paraqet gjykatës, të paktën një herë në vit, brenda tremujorit të parë të vitit. Kriteret dhe rregullat e hollësishme për hartimin e listës së administratorëve miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit publik;

d) cakton ose kontraktin administratorët e pasurisë së sekuestruar me vendim gjykatë ose urdhër administrativ;”.

3. Në pikën 2, shkronja “h”, fjala “personelit” zëvendësohet me fjalën “ekspertëve”.

Neni 9

Neni 10 shfuqizohet.



Neni 10

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Administratori i pasurisë së sekuestruar caktohet nga kryeadministratori i Agjencisë.”.

2. Në pikën 2, shkronja “e”, nënndarja “iii” ndryshohet si më poshtë:

“iii) informacione periodike për administrimin e pasurive të sekuestruara, të shoqëruara me dokumentet përkatëse.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kryeadministratori, me kërkesë të organit që ka vendosur masën e sekuestros apo kryesisht, shqyrton e vendos për shkarkimin e administratorit të caktuar për administrimin e pasurisë objekt i masës, për paaftësi ose mospërmbyllje të detyrës, si dhe për zëvendësimin e tij, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.”.

Neni 11

Në nenin 13, pika 3, fjalët “i caktuar nga gjykata” zëvendësohen me fjalët “i caktuar nga Agjencia”.

Neni 12

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjala “gjykata” zëvendësohet me emërtesën “Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Agjencia i paraqet Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar kërkesë të argumentuar, ku çmon se duhet të kryhen veprimet juridike, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni. Komiteti autorizon veprimet e kërkuara, kur e çmon të domosdoshme, për ruajtjen e vlerës së pasurisë.”.

Neni 13

Në nenin 15, pika 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) raporte periodike dhe sa herë kërkohet nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.”.

Neni 14

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “në prani të administratorit koordinator,” hiqen.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Inventari dhe përshkrimi i pasurisë së sekuestruar bëhen nga Policia Gjyqësore dhe dokumentohen në një raport, i cili nënshkruhet nga administratori i pasurisë së sekuestruar dhe oficeri i Policisë Gjyqësore, si dhe, sipas rastit, nga të pranishëm të tjerë. Ky raport përmban elementet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile.”.

Neni 15

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Marrja në dorëzim e pasurisë së sekuestruar bëhet nga Agjencia, në përputhje me urdhrin e lëshuar nga organi administrativ kompetent, sipas fushës së zbatimit të këtij ligji.”.

2. Në pikën 3, fjala “ministri” zëvendësohet me fjalët “organi administrativ kompetent” dhe në fjalinë e fundit, fjala “i ministrit” zëvendësohet me fjalët “i organit administrativ kompetent”.

3. Në pikën 4, paragrafi i parë, fjalët “ministri përgjegjës për financat” zëvendësohen me “ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 16

Në nenin 20, pika 3, fjalët “me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “me vendim të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar”.

Neni 17

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Për pasuritë, të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit, me kërkesë të Agjencisë, Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar vendos përdorimin e të drejtave reale nga të tretët, nisur nga parimet e miradministrimit të pasurisë. Të drejtat reale nuk kalohen te personat e parashikuar në pikat 1 e 2, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, si dhe të parashikuar në aktin



normativ nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”.”.

2. Në pikën 2, fjala “gjykata” zëvendësohet me emërtesën “Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar”.

3. Në pikën 4, fjalët “ministrit përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 18

Në nenin 23, pika 2, fjalët “këshillimor” dhe “të ekspertëve” hiqen dhe fjalët “ministrit përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 19

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar

1. Për mbikëqyrjen e veprimtarisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga ana e Agjencisë, sipas fushës së veprimtarisë të përcaktuar në nenin 3, të këtij ligji, dhe kryerjen e funksioneve të tjera të parashikuara nga ky ligj, si dhe për vendimmarrjen për përdorimin e këtyre pasurive, funksionon Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, i ngritur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.

2. Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar vendos për destinimin e pasurive, si dhe për përdorimin efektiv të të ardhurave brenda buxhetit të shtetit, përfshirë edhe vendimin për pagimin e shpenzimeve operative të Agjencisë”.

Neni 20

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, me vendim, përcakton mënyrën dhe kushtet e përdorimit, destinimin e pasurive të konfiskuara dhe nxjerr udhëzimet shoqëruese të përdorimit, brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit tekniko-financiar dhe rekomandimet nga Agjencia, por jo më vonë se 120 ditë nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor.”.

2. Në pikën 2, fjalët “ministrit përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

3. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë, fjala “urdhrit” zëvendësohet me fjalën “vendimit” dhe fjala “ministri” me fjalën “komitet”.

b) Në shkronjën “a”, emërtesa “Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar” zëvendësohet me fjalën “Agjencisë”.

Neni 21

Në nenin 26, shkronja “b”, në fjalinë e dytë, fjalët “ministri përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për ekonominë”.

Neni 22

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Raportimi periodik në Këshillin e Ministrave

Agjencia, në muajin janar të çdo viti, i paraqet Këshillit të Ministrave dhe komisionit përgjegjës për çështjet ligjore të Kuvendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, raportin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përgjatë vitit pararendës, sipas këtij ligji.”.

Neni 23

Në nenin 29, pika 2, fjalët “Ministri përgjegjës për financat” zëvendësohen me fjalët “Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 24

Në nenin 30, pika 5, fjalët “Ministri përgjegjës për financat,” zëvendësohen me fjalët “Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike,”.



Neni 25

Në nenin 31, pas pikës 1 shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Shpenzimet që nevojiten për ruajtjen e sendeve provë materiale, sipas përcaktimit të bërë në këtë ligj, përballohen nga Agjencia dhe në rastet e disponimit të tyre në favor të shtetit, ajo ka të drejtën e mbajtjes së vlerës në masën që është e nevojshme për përballimin e shpenzimeve të ruajtjes.”.

Neni 26

Dispozitë kalimtare

1. Përcaktimet e bëra në nenet 4, shkronja “ç”, 7, shkronjat “c1”, “c2”, 17, pika 1, të këtij ligji, të cilat i referohen aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”, do të kenë efekt të përkohshëm dhe do të zbatohen deri në datën 31.12.2020.

2. Provat materiale, të cilat ruhen pranë strukturave të Policisë së Shtetit apo pranë enteve të tjera të caktuara nga organi procedues, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kalojnë në ruajtje dhe në administrim të Agjencisë.

Neni 27

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që të nxjerrin aktet nënligjore, në zbatim të neneve 5, 8, 15, 16, 17, 20, dhe 24, të këtij ligji, brenda 30 ditëve, por jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e tij.

2. Çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2020

VENDIM
Nr. 269, datë 1.4.2020**PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË
PËRBASHKËT TË PËRGATITUR NGA
SEKRETARIATI I PËRHERSHËM I
KOMUNITETIT TË TRANSPORTIT
DHE SEKRETARIATI I CEFTA-S, PËR
TË LEHTËSUAR TRANSPORTIN DHE
TREGTIMIN E MALLRAVE TË
NEVOJËS SË PARË BREDA
BALLKANIT PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore, ratifikuar me ligjin nr.9696, datë 21.3.2007, si dhe traktatit që themelon Komunitetin e Transportit, ratifikuar me ligjin nr.8/2018, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për miratimin e propozimit të përbashkët të përgatitur nga Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit dhe Sekretariati i CEFTA-s, për të lehtësuar transportin dhe tregtimin e mallrave të nevojës së parë brenda Ballkanit Perëndimor, sipas tekstit dhe hartës që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**Propozim i përbashkët i përgatitur nga
Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të
Transportit dhe Sekretariati i CEFTA-s për të
lehtësuar transportin dhe tregtimin e mallrave
të nevojës së parë brenda Ballkanit
Perëndimor**

Përhapja e COVID-19 ditëve të fundit në të gjithë kontinentin Evropian çoi në vendosjen e masave shumë të forta nga disa vende anëtare të BE në nivelin e BE-së, me qëllim që të frenonte rrezikun e transmetimit të virusit. Shembujt më të dukshëm të një politike të tillë janë ndalimet e udhëtimit të vendosura nga disa vende anëtare dhe rivendosja e kontrolleve kufitare (përfshirë qëllimet sanitare) në kufijtë e brendshëm dhe të jashtëm të BE-së. Për të zvogëluar ndikimin e këtyre masave në tregun e brendshëm të BE-së, Komisioni ka propozuar të hënën më 16 mars mbylljen e kufijve të jashtëm të BE-së për një kohëzgjatje, për momentin, prej 30 ditësh. Propozimi ka si objektiv para së gjithash lëvizjen e udhëtarëve në të gjithë kufijtë e jashtëm ose BE dhe në parim nuk duhet të ndikojë në transportin dhe tregtinë me fqinjët.

Partnerët e Ballkanit Perëndimor, ndërkohë, kanë marrë edhe disa masa kufizuese, shpesh të pakoordinuara, për udhëtimin dhe transportin e mallrave, të cilat të kombinuara me ato të marra nga vendet anëtare të BE-së, po rrisin bllokimet në disa kalime kufitare, me radhë të gjata dhe vonesa të gjata për të kaluar kufirin, me efekt potencialisht negativ në situatën sanitare, por edhe në furnizimin e mallrave thelbësore.

Sidoqoftë, pavarësisht urgjencës sanitare, lëvizja e mallrave dhe mbi të gjitha e mallrave me nevoja parësore (ushqim, ushqim për kafshë, ilaçe, pajisje mjekësore) nuk duhet të ndërpritet.

Duke qenë se kjo urgjencë sanitare do të zgjasë për një kohë të caktuar, përtej pasojave në drejtim të humbjes së jetës së njerëzve, ekonomia e përgjithshme e kontinentit dhe përbërësi i saj tregtar mund të ndikohen shumë. Partnerët rajonalë të Ballkanit Perëndimor kanë shprehur frikën e tyre se mund të ketë një ndërprerje të trafikut të mallrave që mund të çojë në mungesë të mallrave thelbësore duke prekur jetën e miliona qytetarëve në rajon.

Dokumenti i mëposhtëm paraqet një përpjekje për të propozuar një qasje më të koordinuar dhe proporcionale në përgjigje të sfidës me të cilën ne

po përballemi të gjithë për të frenuar përhapjen e COVID-19. Ai synon të shmangë që asnjë nga palët e interesuara të mos përballet me një izolim shumë të rëndë që çon në mungesë të mallrave të domosdoshmërisë së parë.

Ky dokument synon të lehtësojë tregtinë dhe transportin e mallrave duke trajtuar vetëm masat parandaluese shitesë të marra ose që duhet të ndërmerren për të siguruar frenimin e shpërthimit të COVID-19. Doganat dhe kontrollet e tjera të mallrave në tregtinë e ligjshme mbeten nën rregullat e tregtisë së CEFTA dhe rregullave që rrjedhin nga Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA) midis BE-së dhe partnerëve rajonalë.

Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit dhe Sekretariati i CEFTA propozojnë një sërë masash për të mbështetur partnerët e Ballkanit Perëndimor, por edhe vendet anëtare të BE-së për të përballuar sfidat e transportit dhe tregtisë të lidhura me shpërthimin e sëmundjes COVID-19.

Qasja e propozuar bazohet në dy shtylla dhe dy faza:

Së pari, identifikimi i një numri të kufizuar të pikave të kalimit kufitar dhe ato të përbashkëta prioritare rrugore dhe porteve kryesore që duhet të vazhdojnë të funksionojnë në të gjitha rrethanat. Për të gjitha këto pika lidhëse, një seri masash është propozuar për të lehtësuar punën / bashkëpunimin midis administratave të ndryshme të përfshira.

Ai gjithashtu identifikon një seri të "akseve të gjelbra" që lidhin gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor së bashku në të cilat duhet të lejohet qarkullimi i lirë i trafikut, së bashku me një numër të kufizuar të pikave të karburantit, të cilat mund të mbeten të hapura edhe në rast të një kontaminimi të mundshëm të popullatës. Kjo pikë është thelbësore për të siguruar që drejtuesit e kamionëve / kamionët mund të vazhdojnë të funksionojnë pavarësisht kësaj situatë të degraduar.

Paralelisht, Komisioni Evropian lëshoi *Komunikimin për zbatimin e Linjave të Gjelbra nën Udhëzimet për masat e menaxhimit të kufijve për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin e disponueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve thelbësore C (2020) 1897, nga 23.3.2020. Paragrafi 15 nga Komunikimi, i cili ka të bëjë me BP6, thotë qartë se kontrollet standarde të mallrave midis vendeve anëtare të BE dhe fqinjët BP6 duhet të vazhdojnë në të njëjtën mënyrë, ndërsa aspektet*



e tjera të udhëzimeve duhet të zbatohen sa më shumë që të jetë e mundur:

"Pa paragjykuar kontrollet specifike mbi mallrat ose punëtorët e transportit, të lidhura në mënyrë natyrale dhe të zakonshme me kalimin e kufijve të jashtëm të tregut të vetëm, bashkimin doganor ose zonën Shengen, përkatësisht, Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë në masën më të madhe të mundshme në kufijtë e tillë të jashtëm udhëzimet e zbatimit të përcaktuara në këtë Komunikim."

Komisioni ngarkoi Sekretariatit e Përhershëm të Komunitetit të Transportit për të lehtësuar koordinimin dhe zbatimin e masave midis BE-së dhe Gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Masat që do të vendosen për të përmirësuar koordinimin midis shteteve anëtare dhe palëve të Ballkanit Perëndimor, sidoqoftë, do të trajtohen në një dokument të veçantë.

I. MBLEDHJA E INFORMACIONIT

Roli i Sekretariatit të Përhershëm të Komunitetit të Transportit: duke ndjekur një qasje të ngjashme të udhëzimeve të BE-së botuar kohët e fundit C (2020) 1753 final të datës 16.3.2020 *"Çdo kufizim i planifikuar në lidhje me transportin duhet t'i njoftohet Komisionit dhe të gjitha Shteteve të tjera Anëtare në kohën e duhur dhe, në çdo rast, përpara se ato të zbatohen, partnerët e Evropës Juglindore duhet të udhëzohen të informojnë Sekretariatit e Përhershëm të Komunitetit të Transportit për çdo masë të tillë që po ndërmarrin ose planifikojnë të ndërmarrin në një afat të shkurtër dhe që kanë një ndikim në lëvizjen e mallrave dhe personave."*

Komunikimi: Sekretariati ka filluar nga e hëna 16 mars për të monitoruar masat dhe për të mbledhur të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me kufizimet e udhëtimit të marra nga partnerët e Ballkanit Perëndimor. Sekretariati ofron një panoramë të plotë të situatës për publikun (administratat - qytetarë - biznes) mbi statusin aktual të kufizimeve të lidhura me transportin në rajon në faqen e tij në internet www.transport-community.org dhe përmes llogarisë së tij në Twitter. Informacioni perditesohet çdo ditë. Sekretariati i TCT-së gjithashtu raporton për situatën në BE – BP dhe ndarjen e informacionit në lidhje me veprimet dhe masat që janë marrë në nivelin e BE-së ose nga shtete të vecanta anëtare të BE-së, të cilat gjithashtu mund të gjenden në adresën: https://ec.europa.eu/transport/koronavirus-response_en

Sekretariati i CEFTA ka për detyrë të mbledhë informacione mbi masat që ndikojnë drejtpërdrejt dhe indirekt në tregti, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: masa që kufizojnë drejtpërdrejt importin, eksportin ose tranzitin, masa shtesë që lidhen me zhdoganimin e mallrave në kufi, pikat operative të hyrjes së mallrave. Palët e CEFTA-s informojnë rregullisht Sekretariatit. Sekretariati shpërndan informacionin tek Palët dhe në Forumin e Investimeve të Dhomës të BP6 me qëllim informimin e komunitetit të biznesit. Sekretariati do të sigurojë informacionin rregullisht në faqen e tij të internetit www.cefta.int dhe përmes llogarive të tij në rrjetin social.

Sekretariati TCT dhe Sekretariati i CEFTA shkëmbejnë informacione në mënyrë të rregullt dhe koordinojnë mbledhjen e të dhënave për të siguruar mbështetje për ekonomitë e BP6 dhe për të siguruar një rrjedhë efikase të informacionit.

II. PËRMIRËSIMI I KOORDINIMIT

Siç u tha më lart, një nga aspektet kritike që është duke sfiduar transportin e mallrave në Ballkanin Perëndimor është mbajtja e të gjithë partnerëve të lidhur së bashku si dhe siguri i lidhjeve me shtetet anëtare të BE për të garantuar flukset thelbësore të tregtisë për një rajon i cili merr mesatarisht 70% të importeve të tij nga shtetet anëtare të BE-së.

Si hapi i parë drejt një koordinimi gjithëpërfshirës, Palët kanë krijuar një Strukturë Koordinuese të CEFTA-s, e ngarkuar me shkëmbimin e të gjitha informacioneve që lidhen me tregtinë e mallrave. Struktura përbëhet nga përfaqësues të ministrive përgjegjëse të tregtisë (Pika e Kontaktit CEFTA) dhe administrata doganore. Puna e strukture mbështetet nga Sekretariati i CEFTA-s.

2. 1 Korridorët e Gjellbërt Prioritarë në Ballkanin Perëndimor

Si hap i parë, propozohet të identifikohet në rrjetin rrugor kryesor TEN-T të partnerëve të Ballkanit Perëndimor "korridoret e gjellbërt prioritarë", mbi të cilat duhet të lejohet qarkullimi i lirë - për mallrat e domosdoshmerise së parë (shiko hartën në aneksin 1).

Korridoret prioritarë të gjellbërt përfshijnë tre degëzime:

Kufiri HU/SRB - Belgrade – Kufiri SRB/MK - Skopje – Kufiri MK/EL (me një degezim drejt Kosovës dhe Prishtinës) || Kufiri RO/SRB -



Belgrade – Kufiri SRB-MNE - Podgorica – (porti i Bar-it.

Kufiri HR/BiH – Sarajevo - (porti i Ploce (HR) || Kufiri HR/SRB – Belgrade - Kufiri SRB/BG.

(Porti i Durrësit – Tërana - ALB/MK border-Skopje - Kufiri MK/BG || Kufiri ALB/KOS – Pristina - Kufiri KOS/MK || Kufiri ALB/MNE - Podgorica.

2.2 Maksimizimi i përdorimit të rrjetit rrugor

Orët e lejuara të transitit të unifikuar në secilin nga vendet partnere WB6. Koha e kaluar në territorin e një partneri WB6 për kamionët duhet të lejohet që ky të ngarkojë/ose shkarkojë dhe të largohet nga territori. Një periudhë që nuk kalon 12 orë nga momenti i hyrjes, duket të jetë e arsyeshme.

Stacionet e karburantit, përgjatë këtyre korridoreve të gjelbërta duhet të jenë të disponueshme për të lejuar drejtuesit e kamionëve të furnizohen me karburant dhe të pushojnë.

Pezullimi i përkohshëm i të gjitha llojeve të kufizimeve të drejtimit të mjeteve në fuqi (ndalimet e fundjavës, ndalimet e natës, ndalimet sektoriale, etj.) për transportin e mallrave, veçanërisht në nyjet urbane. Pezullimi i këtyre ndalimeve të drejtimit të mjeteve do të kontribuojë në rritjen e rrjedhshmërisë së trafikut dhe shkurtimin e kohës kur mallrat arrijnë në destinacion.

2.3 Pikat e “Gjelbra” Prioritare të kalimit kufitar/të përbashkët

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pikave kufitare/të përbashkëta. Të gjitha këto pika duhet të vendosin "korsi të gjelbër me përparësi " kushtuar trafikut me rëndësi parësore, si vijon:

1. Transporti i mallrave me rëndësi parësore duhet të ketë përparësi në lidhje me mallrat e tjera përmes "korsive të gjelbra". Fluksi i trafikut duhet të garantohet përmes operacioneve 24/24 orë në pikat kyçe kufitare/të përbashkëta ku procedurat doganore dhe fito-sanitare do të kryhen në mënyrën më efikase për të gjitha mallrat që konsiderohen si domosdoshmëri parësore. Kontrollat sanitare të drejtuesve dhe automjeteve (nëse aplikohen) duhet të jenë në gjendje të operojnë 24/24 orë.

2. Transporti pa pengesa në këto pika kyçe do të jetë thelbësore për të ruajtur disponueshmërinë e mallrave, në veçanti të mallrave thelbësorë siç janë furnizimet ushqimore, bagëtitë, ushqimi i kafshëve, kimikatat dhe furnizimet dhe pajisjet mjekësore thelbësore. Struktura Koordinuese e CEFTA

koordinon krijimin e një liste të vetme të mallrave, të identifikuar nga kodi tarifor 8 shifror.

3. Informacioni i para-mbërritjes për mallrat thelbësore do të shkëmbehet në mënyrë elektronike brenda-CEFTA-s përmes Sistemit të Shkëmbimit Elektronik të të Dhënave (shiko shtojcën 2), i cili tashmë është në fuqi dhe mbështet shkëmbimin e të dhënave midis Administratave Doganore në CEFTA-s. Administratat Doganore në CEFTA-s do të sigurojnë që të gjitha deklaratat e eksportit dhe tranzitit të dërgohen në SEED (para-mbërritjes dhe daljes). Njoftimet e para-mbërritjes për mallrat thelbësore do të dërgohen gjithashtu jo vetëm te administrata doganore, por edhe te palët e tjera të interesuara përkatëse, si inspektimet sanitare, fitosanitare dhe veterinare. Ndërsa vendkalimet kufitare me BE-në aktualisht janë jashtë fushëveprimit të SEED, shtrirja e sistemit në pikat kryesore kufitare të BE-BP6 të listuara në Rrjetin TEN- T do të ishte në dobi të të gjithëve dhe duhet të konsiderohet një përparësi.

4. Propozimi ka të bëjë me PKK (Pikë Kalimi Kufitar) / PPK (Pikë e Përbashkët Kufitare) rrugore, si vijon (shiko hartën në fund të materialit):

Në korridorin A (brenda Ballkanit Perëndimor):

-SRB-MK (Preshevë/Tabanovce)

-SRB- MNE (Dobrakovo/Gostun)

-SRB-KOS (Merdare/Merdare)

Në Portin e korridorit të Barit (MNE)

Në Korridorin B:

-MNE-KOS (Kula/Kulina)

Në Korridorin C:

-Porti i Durrësit (ALB)

-KOS-ALB (Vermice / Morine)

-MK-KOS (Bllacë / Hani i Elezit)

-ALB-MNE (Hani i Hotit / Bozaj)

-ALB-MK (Qafe Thane / Kjaftasan)

5. Lista e PKK / PPK-ve kryesore të identifikuar më lart është minimumi i kërkuar për të siguruar qarkullimin e furnizimeve emergjente. Sidoqoftë, autoritetet mund të vendosin t'i mbajnë të tjera PKK-të e hapura për transportin e mallrave, me kusht që të mos ndikojë në menaxhimin efektiv të PKK-ve/PPK-ve rrugore kryesore.

6. Partnerët rajonalë duhet të sigurojnë që në PKK/PPK rrugore të listuara më lart:

-Asnjë çertifikatë shtesë nuk duhet të vendoset për mallrat që qarkullojnë në mënyrë të ligjshme në tregjet e CEFTA-s dhe tregut të vetëm të BE-së



-Automjetet dhe anëtarët e ekuipazhit mund të jenë subjekt i kontrolleve shëndetësore dhe masave sanitare në hyrje në bazë të udhëzimeve dhe rekomandimeve të OBSH-së, por si parim nuk duhet të ketë kufizime hyrëse ose trafiku përsa kohë që dëshmohet shëndeti i mirë. Palët do të forcojnë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente në mënyrë që të lehtësojnë lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe të arrijnë standarde sanitare të nivelit të lartë.

-Mund të vendosen kufizime për numrin maksimal të kamionëve të caktuar në ditë, me kusht që të merren vesh në mënyrë të koordinuar përmes Trupit Koordinues të CEFTA-s dhe të jetë komunikuar qartë.

-Mund të vendoset një sistem i thjeshtë "planifikimi", me qëllim që të shmangen radhët në kufijtë e jashtëm me Shtetet Anëtare (MS) të BE, me anë të të cilit transportuesit e mallrave mund të marrin informacione për kohën e përafërt për mbërritjen e kamionëve të tyre në PKK, përmes një Call Center të thjeshtë, që duhet të hapen nga autoritetet doganore. Sistemi gradualisht mund të bëhet digjital (siç u përmend më lart) dhe të lejojë planifikimin elektronik, derisa të vendoset një sistem elektronik i menaxhimit të radhës (eQMS).

-Potencialisht (kur koha dhe burimet e lejojnë) duhet të ngrihet një platformë dixhitale për të gjurmuar kamionët përgjatë korsive të gjelbërta, në mënyrë që të planifikojë dhe menaxhojë orët e kalimit kufitar me qëllim të shmangies së radhëve dhe të sigurojë distancimin shoqëror në pikat e kalimit kufitar.

7. Autoritetet duhet të sigurojnë që PKK-të kryesore rrugore që i shërbejnë këtyre korridoreve "të gjelbër" prioritare, duhet t'u jepet përparësia më e lartë përsa i përket burimeve njerëzore (punonjësit e zakonshëm / te policisë / sanitaret) dhe pajisjet për menaxhimin efikas të kufijve, për të qenë në gjendje të përgjigjen në mënyrë të duhur dhe përshtatën në situatat aktuale. I gjithë personeli nga PKK-të e mbyllura duhet të zhvendoset në ato kryesore dhe ndërresat duhet të planifikohen në përputhje me rrethanat. Të gjitha objektet sanitare duhet të vendosen pa vonesa.

8. Është gjithashtu me rëndësi parësore që, nëse këto mallra transportohen nëpërmjet porteve, të gjitha operacionet doganore të kryhen të njëjta me ato të propozuara për pikat kufitare tokësore, duke vendosur disa "korsi të gjelbra" për të shpejtuar

procedurat, duke siguruar një furnizim të shpejtë për përdoruesit fundorë.

Të gjitha masat e vendosura duhet të përputhen me rregullat përkatës të tregtisë, veçanërisht marrëveshjet e WTO-së, CEFTA-s dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe udhëzimet e KE-së për masat e administrimit të kufijve për të mbrojtur shëndetin dhe për të siguruar disponueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve thelbësore. Në veçanti, në lidhje me drejtuesit dhe ndërmarrjet përkatëse të lidhura me transportin, Palët duhet të kërkojnë të koordinojnë masat, veçanërisht duke marrë parasysh rekomandimet nga Shtojca 1 të Komunikimit për zbatimin e *Linjave të Gjelbërta nën Udhëzimet për masat e menaxhimit të kufijve për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin e disponueshmërinë se mallrave dhe shërbimeve thelbësore*.

Shtojca 1 e propozimit jep një përshkrim të hollësishëm të pikave të ndryshme kufitare / të përbashkëta, të nxjerra nga një studim i kryer kohët e fundit nga "CONNECTA" në kuadër të ndihmës së BE për Ballkanin Perëndimor. Duke patur parasysh uljen e trafikut (pasagjerët por edhe ngarkesat) duhet të jetë e mundur të sigurohet që mallrat parësore mund të kalojnë kufijtë dhe të arrijnë zonën e destinacionit të tyre në një kohë të arsyeshme. Kjo nënkupton që masat e koordinuara, siç përshkruhet në këtë propozim, janë marrë në mënyrë të koordinuar nga të 6 vendet partnere të Ballkanit Perëndimor dhe janë zbatuar me shpejtësi.

Kjo gjithashtu nënkupton që punonjësit e transportit, në veçanti, drejtuesit e kamionëve mund të operojnë në kushte të sigurt. Kjo përfundimisht nënkupton që të gjitha stafet kufitare gjithashtu mund të veprojnë në mënyrë të sigurt. "Vazhdimësia" e trafikut mund të jepet në këto kushte dhe do të shmangte ndërprerjen e furnizimit të mallrave me rëndësi parësore që mund të ndikojnë rëndë dhe për një periudhë të gjatë kohore ekonomitë dhe shoqëritë tona.



ANEKSI 1: Karakteristikat teknike të Kufirit rrugor “jeshil” dhe Pika e Kalimit të Përbashkët (të dhëna nga 2017, ekstrakt nga Studimi CONNECTA për lehtësimin e rrugëve të pikave kalimeve kufitare)

SRB-MK (Preshevë/Tabanovc)

Numri i korsive për pasagjerë: 4 + 6/12

Numri i korsive për transport mallrash: 2 + 2/2 + 2

Kapaciteti i parkimit të kamionëve: 100

Kapaciteti në radhë (kamionë): 200

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: rreth 288.000

SRB- MNE (Dobrakovo/Gostun)

Numri i korsive për pasagjerë: 2 /

Numri i korsive për transport mallrash: 2 + 1/1 + 2

Kapaciteti i radhës (kamionë): /

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: 150.000

SRB-KOS (Merdare-Merdare)

Numri i korsive për pasagjerë: 1 + 1/1 + 1

Numri i korsive për transport mallrash: 1 + 1/1 + 1

Kapaciteti i parkimit të kamionëve:

Kapaciteti i radhës (kamionë):

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: 94.000

MNE-KOS (Kula-Kulina)

Numri i korsive për pasagjerë: 2 + 1/1 + 1

Numri i korsive për transport mallrash: / 1 + 1

Kapaciteti i parkimit të kamionëve:

Kapaciteti i radhës (kamionë): 3 + 3/10 + 10

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: 20.000

ALB-MK (Qafe Thane/Kjafasan)

Numri i korsive për pasagjerë: 3/3 + 2

Numri i korsive për transport mallrash: 1/1 + 2

Kapaciteti i parkimit të kamionëve: /

Kapaciteti i radhës (kamionë): 50 /

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: 50.000

ALB-MNE (Hani i Hotit/Bozaj)

Numri i korsive për pasagjerë: 3 + 2/1 + 1

Numri i korsive për transport mallrash: / 1 + 1

Kapaciteti i parkimit të kamionëve: terminal /

Kapaciteti i radhës (kamionë): /

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: 66.000

MK-KOS (Bllacë/Hani i Elezit)

Numri i korsive për pasagjerë: 1 + 1 /

Numri i korsive për transport mallrash: 3 + 4/1 + 2

Kapaciteti i parkimit të kamionëve: 50 + 50

Kapaciteti i radhës (kamionë): /

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: 39.000

ALB-KOS (Morinë- Vërmicë)

Numri i korsive për pasagjerë: 1 + 1/4

Numri i korsive për transport mallrash: /2

Kapaciteti i parkimit të kamionëve:

Kapaciteti i radhës (kamionë): /24

Numri vjetor i kamionëve që kalojnë në PKK: 137.000

ANEKSI 2: SEED – Shkëmbimi Sistematik Elektronik i të Dhënave

Përmbledhje e shkurtër

Që nga faza e parë e zbatimit në vitin 2010, përmes disa projekteve të financuara nga BE-ja, Shkëmbimi Elektronik Sistematik i të Dhënave (SEED) ka përmirësuar menaxhimin e kufijve në Ballkanin Perëndimor, duke nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Administratave Doganore. Me kalimin e viteve, SEED u bë një mjet i fuqishëm për të kapërcyer joefikasitetet në sistemet e menaxhimit të kufijve të Ballkanit Perëndimor dhe lehtësoi: thjeshtimin e procedurave të eksportit, tranzitit dhe importit; zvogëlimin e kohës për flukset legjitime të tregtisë; zvogëlimin e rreziqeve të sigurisë; si dhe arritjen e standardeve të BE-së drejt integritimit në BE.

Gjendja aktuale e SEED është si vijon:

- Baza ligjore për shkëmbimin e të dhënave elektronike sigurohet në të gjithë rajonin përmes protokolleve bilaterale të nënshkruara ndërmjet administratave doganore fqinje dhe forcohen dhe

zgjerohen më tej përmes miratimit të Protokollit Shtesë 5 të CEFTA-s dhe Aneksëve të saj;

-Udhëzimet operacionale dhe udhëzimet për përdorimin e sistemit SEED janë miratuar nga secila administratë doganore përfituese;

-Infrastruktura dhe sistemi informatik është themeluar, funksionon 24/7 dhe mundëson përputhjen automatike të të dhënave doganore dhe modulën e alarmit në të dhënat e para-ardhjes, në veçanti:

-Infrastruktura SEED është e përbërë nga 7 nyje (Tiranë, Banja Luka, Podgoricë, Shkup, Beograd, Prishtinë, Romë) dhe 9 lidhje direkte për

shkëmbimin e të dhënave + 2 lidhje me “serverin e mesëm”: Prishtinë-Romë dhe Beograd-Romë. Këto lidhje mbuluan të gjitha pikat e kalimit brenda rajonit.

-Mbështetja e moduleve të softuerit SEED: vrojtimit i të dhënave të shkëmbyera (para mbërritjeve, daljet e mia, hyrjet e mia); regjistrimi manual i të dhënave që mungojnë; përputhja e të dhënave; statistika; alarm; deklaratat e parave; karnete ATA; rimbursim i TVSH-së; llogaritja e borxheve doganore në trafikun e pasagjerëve; arkivimi i të dhënave dhe administrimi;




- Shkëmbimi i të dhënave është vendosur në të gjitha pikat e kalimit brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Çdo kalim i secilës gjurmë në rajon përfshihet në sistem. Kjo aplikohet si për mjetet e transportit të ngarkuara (të gjitha llojet e procedurave: thjeshtim i procedurave, eksport/tranzit/ import, karnetet TIR/ATA), si dhe kamionët bosh.

Planet për të ardhmen – SEED +

Implementimi i Protokollit Shtesë 5 (PSH5) është parë si një shenjë e fortë e gatishmërisë së Palëve të CEFTA-s për të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e nevojshme për thellimin e tregtisë rajonale përmes thjeshtimit dhe lehtësimit të procedurave doganore dhe reduktimit të formaliteteve të lidhura me tregtinë. SEED + (një version i përditësuar i SEED) ka për qëllim të jetë mjeti kryesor teknik për zbatimin e PSH5 dhe një sërë aktiviteteve të tjera nga MAP REA.



Sistemi SEED + do të përfshijë autoritetet SPS (inspektime fitosanitare dhe veterinare) dhe Agjencitë për ilaçe nga Palët e CEFTA-s të Ballkanit Perëndimor në shkëmbimin e të dhënave elektronike rajonale. Certifikatat dhe dokumentet e tjera të rëndësishme do të shkëmbehen paraprakisht, me qëllim lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurave të kalimit kufitar dhe formaliteteve të zhdoganimit. Gjithashtu përfshihet zhvillimi i bazave të të dhënave të zakonshme dhe shërbimeve qendrore në përputhje me PSH5 dhe anekset e tij teknike, siç është baza e të dhënave e OAE-ve të CEFTA-s të njohura reciprokisht (Operatorët e Autorizuar Ekonomik), baza e të dhënave të produkteve të pasigurta / jo në përputhje, të zbuluara në tregun e CEFTA-s bazuar në EUROPHYT dhe RAPEX dhe baza e të dhënave rajonale të licencave të lëshuara bazuar në Teknologjinë e Re TRACES (TNT). Përveç përfitimeve të dukshme direkte për palët WB6 të përmendura më lart, zbatimi i SEEDD + do të lehtësojë më tej harmonizimin e proceseve dhe të dhënave me BE-në.

ANEKSI 3 : Harta e Korridoreve të Gjelbra për Transportin e Mallrave të Nevojës së Parë





VENDIM
Nr. 4, datë 30.3.2020

**PËR TRAJTIMIN E PËRKOHSHËM
FINANCIAR MUJOR TË DISA
FUNKSIONARËVE DHE NËPUNËSVE
TË ADMINISTRATËS SHETETËRORE,
GJATË PERIUDHËS SË GJENDJES SË
EPIDEMISË SË SHKAKTUAR
NGA COVID-19**

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 30.3.2020,

VENDOSI:

1.. Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se tre muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.

2. Nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, të bordeve apo të komisioneve të institucioneve të administratës shtetërore, të institucioneve publike të arsimit të lartë, të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por jo më shumë se tre muaj, nuk e përfitojnë shpërbllimin mujor përkatës.

3. Përjashtohen nga zbatimi i pikës 2, të këtij vendimi, nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, bordeve apo komisioneve të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Në kuptim të këtij vendimi, institucione të administratës shtetërore janë ato të përcaktuara sipas ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

5. Institucionet përkatëse, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, të derdhin shumat e papaguara në buxhetin e shtetit, në fondin antiCOVID-19, të miratuar për vitin 2020, në bankën e nivelit të dytë Credins Bank, me numër llogarie në lekë nr.1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.

6. Miratimin, në parim, të projektvendimit të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” të propozuar nga ministri i Shtetit për Rindërtimin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen Kryeministria, aparatet e ministrive, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital mbi 50% shtetëror si dhe institucionet e administratës shtetërore, të cilat, sipas legjislacionit të tyre specifik, kanë këshilla apo borde drejtuese me të drejtë pagese, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINTOR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. _____, datë _____

**PËR TRAJTIMIN E PËRKOHSHËM
FINANCIAR MUJOR TË DISA
FUNKSIONARËVE DHE NËPUNËSVE
TË ADMINISTRATËS SHETETËRORE,
GJATË PERIUDHËS SË GJENDJES SË
EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA
COVID-19**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se tre muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.

2. Nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, të bordeve apo të komisioneve të institucioneve të administratës shtetërore, të institucioneve publike të arsimit të lartë, të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por jo më shumë se tre muaj, nuk e përfitojnë shpërblimin mujor përkatës.

3. Përfshihen nga zbatimi i pikës 2, të këtij vendimi, nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore të cilët janë anëtarë të këshillave, bordeve apo komisioneve të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Në kuptim të këtij vendimi, institucione të administratës shtetërore janë ato të përcaktuara sipas ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

5. Institucionet përkatëse, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, të derdhin shumat e papaguara në buxhetin e shtetit, në fondin antiCOVID-19, të miratuar për vitin 2020, në bankën e nivelit të dytë Credins Bank, me numër llogarie në lekë nr.1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.

6. Ngarkohen Kryeministria, aparatet e ministrive, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital mbi 50% shtetëror si dhe institucionet e administratës shtetërore, të cilat, sipas legjislacionit të tyre specifik, kanë këshilla apo borde drejtuese me të drejtë pagese, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë